



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më
15.01.2016, e cila filloi në orën 11:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, , këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hatixhe Latifi Pupovci (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Kreshnik Ahmeti (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shaip Shabani (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**. Ai bëri të ditur se Presidenca e Kosovës ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës caktimin e lokacionit për vendosjen e një memoriali përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it, të cilët ishin në misionin paqeruajtës

në Kosovë. Me të përfunduar misionin e tyre në Kosovë, ata humbën jetën tragjikisht në një aksident.

Arsyetimin për caktimin e këtij lokacioni e paraqiti **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit.

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan: Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, Qëndron Kastrati, në emër të GP të VV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, Imer Rusinovci, në emër të GP të AAK-LDD-së, Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, Abetare Fazliu, në emër të subjektit politik LB, Cuneyd Ustaibo, në emër të subjektit politik KDTP, Nenad Miladinoviqi, në emër të subjektit politik GIS dhe Sylejman Pireva, duke e përkrahur caktimin e këtij lokacioni. Këto diskutime të plota janë dhënë në transkript.

Imer Rusinovci i njoftoj të pranishmit se shef i Grupit parlamentar të AAK-së do të jetë **Brahim Mehmetaj** (ish-shef i GP të LB-së).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.